

AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI I SHOQËRISË
CS AlbConsulting Shpk

THEMELIMI

Neni 1
Ortaku themelues

- 1.1 Shoqëria CS AlbConsulting Shpk themelohet nga Ortaket si me poshte:
- 1- Z.Fjordi Çela, shtetas Shqiptar, lindur më 16.03.1988, lindur ne Lushnje, banues ne Durres, mbajtes i Kartes se Identitetit me nr.036297317 dhe nr personal :I80316120K.
 - 2- Z.Ervis Sina, shtetas Shqiptar, lindur më 18.09.1989, lindur ne Vlore, banues ne Durres, mbajtes i pasaportes me nr.BE5748760 dhe nr personal : I90918086I.

EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE

Neni 2
Emërtimi

- 2.1 Emërtimi i shoqërisë është CS AlbConsulting.

Neni 3
Forma ligjore

- 3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 4
Baza ligjore



- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e Themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.

Neni 5

Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("QKB").
- 5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është për një afat të përcaktuar.

Neni 6


Selia

- 6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Durrës, Rruga Mujo Ulqinaku, Lagjia 18, Nr Pasurie 16/881, Zk 8511
- 6.2 Administratori i shoqërisë mund të vendosë të hapë degë dhe/ose filiale dhe/ose adresa sekondare dhe/ose zyra përfaqësimi të shoqërisë si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj ose mund të rregjistrojë ato ekzistuese sipas ligjeve në fuqi.
- 6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen në Shqipëri dhe/ose jashtë saj me vendim të Administratorit të shoqërisë.

Neni 7

Emblema. Vula

- 7.1 Shoqëria do të ketë emblemen dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.
- 7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar.
- 7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përmbajnë emblemen dhe vulën e saj.



Neni 8

Objekti

- 8.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është: Sherbime Konsultimi dhe Ndërmejtësim.
- 8.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Ortakeve të shoqërisë.

Neni 9

Kapitali


- 9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 10'000 (Dhjetë mijë) Leke.
- 9.2 Ortaket e shoqërisë zoterojnë:
- 1- Z. Fjordi Çela 1 (një) kuote, me kontribut 5.000 (Pese mijë) leke, 50% të kapitalit të shoqërisë
 - 2- Z. Ervis Sina 1 (një) kuote, me kontribut 5.000 (Pese mijë) leke, 50% të kapitalit të shoqërisë
- 9.3 Kapitali është shlyer tërësisht.

Neni 10

Transferimi i kuotave. Kufizimet.

- 10.1 Kuotat mund të transferohen tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" me amendimet perkatëse.
- 10.2 Vendosja e çfarëdoq barre mbi kuotat në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Ortakeve të shoqërisë.

Neni 11



Rritja e kapitalit

- 11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Ortakeve të shoqërisë.
- 11.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakët e rinj. Ortakët e rinj pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Ortakeve të shoqërisë.

Neni 12

Zvogëlimi i kapitalit


- 12.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni tregtar.
- 12.2 Propozimi i zvogëlimit do t'i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë përpara marrjes së vendimit nga Ortaket e shoqërisë. Eksperti kontabël dhe administratori do të shqyrtojnë propozimin dhe do t'i paraqesin Ortakeve të shoqërisë raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.
- 12.3 Raporti i zvogëlimit të kapitalit do të miratohet me vendim të Ortakeve të shoqërisë.

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 13

Vendimet e Ortakeve të shoqërisë

- 13.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren nga Ortaket e shoqërisë.
- 13.2 Vendimet e Ortakeve të shoqërisë përfshijnë kryesisht:
 - Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
 - Prishjen dhe likuidimin e shoqërisë;



- Emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë si dhe percaktimin e shpërblimit për ta;
- Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar si dhe percaktimin e shpërblimit për ta;
- Miratimin e bilancit të shoqërisë e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- Transformimin e shoqërisë në forma të tjera.

Neni 14 Administrimi

- 14.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator ose një grup administratorësh që caktohen me vendim të Ortakeve të shoqërisë.
- 14.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe drejtojë punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e Ortakeve të shoqërisë.
- 3- Administratori i shoqërisë është Z. Ervis Sina, shtetas Shqiptar, lindur më 18.09.1989, lindur në Vlore, banues në Durrës, mbajtes i pasaportes me nr.BE5748760 dhe nr personal: I90918086I.
- 14.3 Administratori është përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:
- Drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
 - Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose me përfaqësim;
 - Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, përgatitjen dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecursisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
 - Përgatitjen e dokumentave në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zoteron;




- Të zhvillojë veprimtari të tjera të çdo lloj natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektit të saj;
- Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri tek palët e treta, insitucione apo entitete publike ose private;
- Të lidhë për dhe në emër të shoqërisë kontrata me palë të treta;
- Të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet i nevojshëm për mbarëvajtjen e biznesit në Shqipëri;
- Të vendos për ndryshimin e selisë së shoqërisë;
- Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri përpara bankave të nivelit të dytë dhe Bankes së Shqipërisë si dhe të kryej, në emër të shoqërisë cdo transaksion bankar në emër të shoqërisë;
- Të ndërmarrë çdo veprimtari tjetër ose biznes ose aktivitet i cili konsiderohet i nevojshëm për biznesin e shoqërisë në Shqipëri.

14.5 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për 5 (pesë) vjet duke filluar nga data 04.02.2024, me të drejtë ripërtëritje ose deri në çastin e revokimit të tij me vendim të Ortakeve të shoqërisë.

Neni 15

Viti financiar

- 15.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të cdo viti.
- 15.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Zyrën e Tatim Taksave dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

Neni 16

Bilanci. Kontabiliteti.

- 16.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Ortaket e shoqërisë dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.

Ujir Burs

[Signature]

- 16.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislacionit përkatës. Për operacione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.
- 16.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Ortakeve të shoqërisë.

Neni 17

Te Ardhurat. Dividendi

- 17.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezervë për realizimin e qëllimeve të biznesit të saj në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 17.2 Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së cdo ushtrimori, pas pagimit të tatimeve, mund t'i kalojnë Ortakeve të shoqërisë.
- 17.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe ortakët do të përgjigjen deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit të parë deri në tre ushtrimorët vijues.

Neni 18

Likuidimi

- 18.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendimin e Ortakeve të shoqërisë.
- 18.2 Me vendimin e Ortakeve të shoqërisë caktohet një likuidator ose një grup likuidatorësh që do të plotësojnë procedurat e likuidimit.
- 18.3 Likuidatori do të përgatisë raportin e likuidimit mbi gjëndjen ekonomike të shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën që nevojitet për përfundimin e tij. Në përfundim të kësaj procedure, Ortakeve të shoqërisë do të shqyrtojnë bilancin përfundimtar dhe do të miratojnë përfundimin e procedurave të likuidimit.



Neni 19
Mosmarrëveshjet

- 19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

Neni 20
Klauzolë mbyllëse


- 20.1 Ky Statut hartohet në 4 (katër) kopje me fuqi të njëjtë ligjore.

Durres, datë 04/02/2025

CS AlbConsulting Shpk
Ortakët e Shoqërisë

Ervis Sina

ERVIS SINA



Fjordi Çelaj

FJORDI ÇELAJ

